

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI:
“MBROJTJE NGA GERYERJET E LUMIT DEVOLL NE
DESARE, LOTI 2”

1. Hyrje

Projekti i realizimit te mbrotjtjes nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, ne Bashkine Cerrik, synon te identifikojë gjendjen, te propozojë nderhyrjet teknike dhe te gjitha masat e tjera te nevojshme qe lidhen me kryerjen e punimeve per eliminimin e geryerjeve te ndodhura ne segmentet e mbrotjtjes egzistuese te fazes se pare, te ndodhura ne permbytjet e muajit Nentor dhe Dhjetor te vitit 2025 dhe mbrotjtjen nga geryerjet ne segmentet para dhe pas mbrotjtjes egzistuese, te aktivizuara ne keto permbytje.

Objektivi specifik i ketij projekti do te jete qe te siguroje qe punimet dhe nderhyrjet inxhinierike te planifikohen ne menyre te tille qe te plotesohen ne menyren sa me te plote te gjitha kerkesat e parashikuara per zbatimin e punimeve.

2. Detyra e Projektimit:

Ne krahun e majte te rrjedhes se lumit te Devollit ne Desare, si rezultat i prurjeve te lumit te Devollit te shkaktuara nga shirat dhe hapja e HEC te Banjes ne Muajin Nentor dhe Dhjetor 2025, ka ndodhur shkaterimi i blloqeve te betonit te kreut te mbrotjtjes egzistuese te realizuar ne projektin e mbrotjtjes ne Desare ne vitin 2023, ne dy segmente me gjatesi 74 ml dhe 20 ml. Njekohesisht nga prurjet e plotave te ndodhura ne kete periudhe para dhe pas mbrotjtjes egzistuese kane vazhduar geryerjet e bregut te lumit me pasoja te shkaterimit te mbrotjtjes egzistuese nga geryerjet para saj dhe te regyerjeve te tokave bujqesore qe shtrihen pergjate segmentit pas mbrotjtjes egzistuese.

Nepermjet ketij projekti duhet te realizohet mbrotjtja nga geryerjet e bregut para mbrotjtjes egzistuese ne segmentin 1 me gjatesi 70 ml, riparimi i mbrotjtjes egzistuese ne segmentin 2 me gjatesi 74 ml dhe segmentin 3 me gjatesi 20 ml dhe mbrotjtja pas mbrotjtjes egzistuese me gjate 170 ml.

3. Qellimi i projektit

Projekti synon riparimin e mbrotjtjes egzistuese te shkateruar dhe mbrotjtjen e brigjeve te lunit nga geryerjet para dhe pas mbrotjtjes egzistuese, me qellim mbrotjtjen e tokave bujqesore qe shtrihen ne Perendim te Lumit Devoll.

4. Kerkesat e projektit

Ne kete faze do te permbushen te gjitha kerkesat per projektin e zbatimit te mbrotjtjes se shpateve te lumit nga geryerjet.

Vizatimet e projekteve të zbatimit do të përmbajnë:

- a). Horografi ne shkalle 1:10000-1:5000;
- b). rilevimi i zones pergjate shtrirjes së punimeve në shkallë 1:500/1:1000;
- c). profilat gjatesor te mbrotjtjes;
- d). Profila terthore te mbrotjtjes;
- e). Pamje dhe prerje tip të mbrotjtjes të shoqëruara me volumet e punimeve.
- f). Detaje.

Volumet dhe Preventivi

Ne projekt duhet te pasqyrohen volumet për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet do të llogariten mbi bazë të vizatimeve të projektit.

Cmimet njesi për të gjitha punimet do të llogariten duke patur si referencë cmimet Sipas percaktimit te cmimeve te perditesuara nga portali E-albania ne daten e hartimit te tij..

5. Skema e pergjitheshme e mbrojtjes nga geryerjet nga lumi i Devollit ne Desare.

Ne krahun e majte te lumit Devoll ne zonen Desare, si rezultat i prurjeve te lumit gjate shirave te muajve Nentror dhe Dhjetor te vitit 2025 dhe shkarkimeve te plotave nga hidrocentrali i Banjes, ka ndodhur shkaterimi i blloqeve te betonit te kreut te mbrojtjes egzistuese te realizuar ne projektin e mbrojtjes ne Desare ne vitin 2023, ne dy segmente me gjatesi 74 ml dhe 20 ml.

Ky shkaterim ka ndodhur per aresye te futjes se ujit te lumit nga mbrapa mbrojtjes, kjo per shkak te formimit te nje meanderi te krijuar ne distance rreth 100 ml para mbrojtjes, qe e drejtoi nje pjese te rrjedhes se lumit mbrapa mbrojtjes, e favorizuar kjo edhe nga prania e kuotave te uleta ne pjesen e pare te tokes pas mbrojtjes.

Njekohesisht nga prurjet e plotave te ndodhura ne kete periudhe para dhe pas mbrojtjes egzistuese kane vazhduar geryerjet e bregut te lumit me pasoja te gjerjeve te tokave bujqesore qe shtrihen pas segmentit pas mbrojtjes egzistuese.

Duke qene se formacionet e tokes te brigjeve ne zonen e geryer jane formacione te perbera nga perzierje te argjilave, subargjilave mbi shtresat fundore prej zhavori, ne prezence te vazhdueshme nga luhateve te nivelit te lumit, rrembyeshmeria dhe perplasja e ujit thuajse perpendikular me shpatin, krijohen kushte te favoreshme per geryerjet te shpatit te lumit duke geryer njekohesisht me shpatin edhe okat bujqesore qe shtrihen mbi te.


Shkaterimi i mbrojtjes gjatesore egzistuese ka ndodhur ne 2 segmente me gjatesi respektive 74 ml dhe 20 ml, ne distanca 140 ml dhe 210 ml nga fillimi i mbrojtjes.

Ne mbrojtjen egzistuese eshte shkateruar rreshti i kreut te saj, ndertuar me blloqe betoni ne gjatesite respektive 74 ml dhe 20 ml.


Bregu u lumit para mbrojtjes gjatesore eshte geryer ne gjatesine 70 ml dhe njekohesisht ka krijuar carje ne fillimin e argjinatures egzistuese, duke krijuar premisa per vazhdimin e tyre me pasoja futjen e prurjeve te lumit pas mbrojtjes egzistuese duke e shkateruar ate plotesisht.

Ne fund te mbrojtjes egzistuese kane vazhduar geryerjet e bregut te lumit dhe kane ekspozuar bregun ndaj rrjedhes se lumit duke krijuar rezik permanent per avancimin ne tyre dhe geryerjen e tokave bujqesore qe shtrihen mbi breg, njekohesisht duke krijuar rezik te futjes se rrjedhes pas mbrojtjes egzistuese qe fillojn ne distance 170 ml poshte mbrojtjes se pare ne Desare.

Relacion Teknik:
Objekti: "Mbrojtje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, Loti 2"




Relacion Teknik:
Objekti: “Mbrotje nga geryerjet e lumit Devoll ne Desare, Loti 2”





6. PROJEKTI

Projekti i mbrojtjes nga lumi Devoll do te zgjidhe mbrojtjen e brigjeve para dhe pas mbrojtjes egzistuese te realizuar ne fazen e pare me mbrojte gjatesore me gabiona dhe blloqe betoni dhe ne riparimin e segmenteve te shkateruara ne mbrojtjen egzistuese sipas segmenteve:




Segmenti 1:


Mbrojtja ne segmentin 1 do te realizohet me mbrojtje gjatesore me gabiona me gure ne gjatesine 70 ml.

Mbrojtja do te kete lartesine $H=4$ m dhe realizohet me 4 rreshta me lartesi rreshti 1 m.

Pas mbrojtjes depresioni i krijuar nga mendri i lumit do te mbushet me gure me madhesi te barabarte ose me te madhe se 50 cm, me qellim nderprerjen rruges se lumit te krijuar nga meandri , per te siguruar qe rrjedha e lumit te mos kaloje pas mbrojtjes se re dhe asaj egzistues, gje qe do te sh kateronte si mbrojtjen e re dhe ate egzistuese.





Seksion Tip Seksioni 1



Segmenti 2 dhe 3.



Mbrojtja ne keto segmente parashikon riparimin e mbrojtjes egzistuese te fazes se pare ne segmentet 2 me gjatesi 74 ml dhe ne segmentin 3 me gjatesi 20 ml.

Kjo mbrojtje do te realizohet me ndertimin e rreshtit te kreut te mbrojtjes egzistuese me gabiona me gure kavoje me permasa 1x1.5x2 m, duke zevendesuar bloloqet e betonit te shkateruara gjate prurjeve te lumit.



Segmenti 4.


Mbrotjtja ne kete segm,ent me gjatesi 70 ml do te realizohet me mbrotjtje me gure me $D>50$ cm ne forme argjinature, me gjeresi ne kurore $B=3$ m dhe me pjeresi te skarpatave 1:2 ne bjeftin e poshtem, nga ana e shtratit te lumit dhe me pjeresi 1:1.5 nga bjefti i siperm.




Segmenti 5.

Mbrojtja ne segmentin 5 do te realizohet me mbrojtje gjatesore me gabiona me gure ne gjatesine 100 ml.

Mbrojtja do te kete lartesine H=4 m dhe realizohet me 4 rreshta me lartesi rreshti 1 m.





Guret e ndertimit te mbrojtjeve me gabionave do te jene gure kavoje, te mare nga guroret ne kavot me te aferta ne kete zone, ne distance mesatare 20 km.

Vlefta e plote e objektit 38.970.000 leke, nga te cilat ndertim montime 38.258.227 leke, perfshi TVSH dhe mbikqyrje e punimeve 711.773 leke (perfshi TVSH)..

Projektuesi
“ARGI” sh.p.k.
ing. Llambi Tarka